



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçante



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201302432/7

Tiranë ___/___/2015

Lënda : *Rekomandohet marrja e nismës për ndryshim në legjislacion*

Drejtuar : Komisionit për Çështjet ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
Pranë: Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

TIRANE

I nderuar Z. Kryetar!

Institucioni i Avokatit të Popullit, në procesin e shqyrtimit të ankesave të depozituara nga shtetas të ndryshëm, ka konstatuar se, Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor, ka pranuar dhe pranon kërkesa të organit të prokurorisë për vënien në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit, lëshuar nga vet ky organ, për zbatimin e vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë, sipas të cilit është vendosur për dënimin me gjobë të një subjekti. Kryerja e kësaj veprimtarie kryhet nga ana e organeve në fjalë, mbi bazë të një kuadri ligjor i cili mbart kundërshtime.

Sipas parashikimit të kryer në nenin 510 të K.Pr.C., midis të tjerave, janë tituj ekzekutiv:

“ ...

b) *vendimet penale të formës së prerë në pjesën që bëjnë fjalë për të drejta pasurore;*

....

e) *aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutiv dhe ngarkohet zyra e përmbartimit për ekzekutimin e tyre.*

Referuar parashikimit të kryer në dispozitën e sipërcituar, vendimet gjyqësore penale, për dënimin me gjobë të subjektit, nuk përfshihen në kategorinë e vendimeve gjyqësore penale të parashikuar në pikën b), të nenit 510 të K.Pr.C. Pra, sipas këtij parashikimi,

në kategorinë e titujve ekzekutiv përfshihen vetëm vendimet gjyqësore penale në dispozitivin e të cilëve është vendosur dhe për të drejta pasurore.

Përpos kësaj situate, në nenin 467/1 të Ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995, i ndryshuar, (K.Pr.Penale.), parashikohet se :

“Vendimet që përmbajnë dënimin me gjobë ekzekutohen nga zyra e përmbarrimit”, dhe se, sipas nenit 32 të Ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, vënia në ekzekutim e vendimit gjyqësor të formës së prerë, të dënimit me gjobë, bëhet nga organi përmbarrimor, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile, mbi bazë të urdhërit të ekzekutimit të lëshuar nga prokurori.

Në kuptim dhe zbatim të parashikimeve të nenit 510/e të K.Pr.Civile;

“Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv...”..

Vendimi gjyqësor penal i formës së prerë për dënimin me gjobë të një subjekti, nuk është sanksionuar si titull ekzekutiv as në nenin 510, të K.Pr.Civile, dhe as në ndonjë ligj të vecantë, sikurse parashikohet në dispozitën në fjalë, neni 510 të K.Pr.Civile, për pasojë parashikimi i kryer në nenin 467/1 të K.Pr.Penale, është i paplotë, për shkak se, aktin, vendimin gjyqësor penal të formës së prerë për dënimin me gjobë të një subjekti, nuk e përcakton titull ekzekutiv. Në këto kushte, ngarkimi i zyrës së përmbarrimit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale të dënimit me gjobë, nuk vjen në përputhje me kërkesat e nenit 510 të K.Pr.Civile.

Më tej, konstatohet se, Ligji nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, në nenin 32, parashikon se :

“Ekzekutimi i një vendimi dënimi me gjobë bëhet me urdhërin e ekzekutimit të prokurorit në masë, afatet dhe mënyrën e pagimit sipas vendimit të gjykatës. Ekzekutimi bëhet nga organi përmbarrimor në territorin e së cilit ka vendbanimin i dënuari, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile për titujt ekzekutiv”.

Pra, në kundërshtim me parashikimet e nenit 511 të K.Pr.Civile, i cili sanksionon se, në çdo rast urdhëri i ekzekutimit për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv lëshohet nga gjykata, konstatohet se, për vendimet gjyqësore penale të dënimit me gjobë të subjektit, urdhërin për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit për dënimin me gjobë e lëshon prokurori. Kjo situatë e parashikuar në nenin 32 të Ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, vjen në kundërshtim me parashikimin e kryer në nenin 511 të K.Pr.Civile. Pra, neni 32 i Ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, i cili është i miratuar me shumicë të thjeshtë, vjen ndesh me nenin 511 të Kodit të Procedurës Civile, i cili është miratuar me shumicë të cilësuar dhe në hierarkinë e ligjeve prevalon mbi çdo ligj të miratuar me shumicë të thjeshtë, referuar nenit 116 të Kushtetutës.

Në rastin e dënimit me gjobë të subjektit, gjykata, referuar parashikimit të nenit 34 të Kodit Penal, se:

“ ...

Dënimi me gjobë paguhet në afatin e caktuar në vendimin e gjykatës. ...

Kur i dënuari nuk paguan gjobën dhe gjoba nuk mund të vilet nëpërmjet ekzekutimit të detyrueshëm, gjykata vendos zëvendësimin e gjobës me burgim, duke llogaritur pesë mijë lekë për një ditë burgim....”.

përcakton në dispozitivin e vendimit, masën e gjobës, afatin e pagimit të saj, si dhe mënyrën e pagimit nga i dënuari. Caktimi nga ana e gjykatës, i afatit të shlyerjes së dënimit me gjobë, nuk lejojnë kryerjen e veprimeve për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit të dënimit me gjobë nga zyra e përmbarrimit. Në rast se i dënuari nuk shlyen dënimin për pagimin e gjobës në afatin e vendosur nga gjykata, përsëri nuk mund të kryhen veprime për ekzekutimin e vendimit të dënimit me gjobë prej zyrës së përmbarrimit, për shkak se, prokurori, në referim të parashikimit të nenit 467/2, të

K.Pr.Penale, 34 të Kodit Penal, ka detyrimin e kryerjes së kërkesës në gjykatë, për konvertimin e saj në heqje lirie për të dënuarin. Neni 467/2 i K.Pr.Penale parashikon se:

“Kur vërtetohet pamundësia e marrjes së gjobës ose e një pjese të saj, prokurori i bën kërkesë gjykatës që ka dhënë vendimin për të bërë konvertimin....”.

Në mbështetje të kësaj procedure, vjen dhe parashikimi i kryer në nenin 6 të Ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 *“Për ekzekutimin e vendimeve penale”*, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se :

“Vendimet penale vihen në ekzekutim vullentarisht nga i dënuari në mënyrën, kohën dhe vendin e caktuar nga organi kompetent sipas këtij ligji.Vetëm në rast refuzimi të zbatimit vullnetar të tyre, bëhet ekzekutimi i detyrueshëm”.

Procesi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë, referuar kuadrit ligjor të lartpërmendur, kuptohet se, nuk vjen në përputhje me parimin e zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, sikurse sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe nenin 6 të Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Për shkaqet e lartpërmendura, Institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar Ministrin të Drejtësisë, me Shkresën Nr.K2/I40-2 Prot, datë 07.02.2013;

“Marrjen e nismës për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve të cilat parashikojnë procedurat për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale të dënimit me gjobë të subjektit pranë zyrës së përmbarimit”.

Në përgjigje të rekomandimit të dhënë, Ministri i Drejtësisë, me Shkresën Nr.1072/1 Prot, datë 21.03.2014, drejtuar Avokatit të Popullit është shprehur se : *“Ministria e Drejtësisë në rastin e parë të ndërmarrjes së inisiativës për rishikimin e Kodit Penal dhe Ligjit Nr.8331, datë 21.04.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, do të marrë në analizë edhe rekomandimet e përgatitura nga ana juaj mbi këtë çështje, ...”.*

Edhe pse Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me Ligjin Nr.176, datë 18.12.2014 ka vendosur për disa ndryshime në Ligjin Nr.7895, datë 27.01.1995, *“Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”*, ndryshimet e rekomanduara nuk kanë gjetur pasqyrim. Në këto kushte, mbështetur në parashikimet e nenit 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin thuhet se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”*, si dhe nenin 24 të Ligjit nr. 8454, date 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, se: *“ Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkak që krijon premisë për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë : a) t’u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin e përmirësimin e ligjeve...;*

REKOMANDOJMË

“Marrjen e nismës për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve të cilat parashikojnë procedurat për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale të dënimit me gjobë të subjektit pranë zyrës së përmbarimit”.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI